



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË

VENDIM

Nr. 11 Datë 26 / 03 / 2025

Për një saktësim të Vendimit Nr. 49 datë 30.09.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së dhe miratimin e financimit të FSHF-së për ndërtimin e Stadiumit Besa, si dhe dhënien e autorizimit të kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e saj”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligji nr. 44 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 8750, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, VKB Nr. 79 datë 19.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

Të miratojë:

1. Pas pikës 2 të VKB Nr.49 datë 30.09.2024 të shtohen nënpikat me këtë përmbajtje:
 - 2.1. Federata Shqiptare e Futbollit si i vetmi institucion në fushën e sportit të futbollit, do të jetë autoriteti që do të zhvillojë dhe përzgjedhë projektin e zbatimit me anë të prokurimit sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj. Në përzgjedhjen e projektit do të jenë anëtarë edhe përfaqësues të Bashkisë Kavajë.
 - 2.2. Procedura për përzgjedhjen e projektit fitues, zbatimit të projektit dhe supervizionimit të punimeve do të kryhet nga të dyja palët FSHF dhe Bashkia Kavajë.
 - 2.3. Investimi total, do të realizohet si më poshtë:
 - a. Gjatë fazës së miratimit të projektit, Bashkia Kavajë do të kontribuojë me 70% të vlerës së projektit, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit do të kontribuojë në masën 30%. Bashkia Kavajë do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, për llogari të Operatorit Ekonomik fitues.
 - b. Pjesa tjetër e investimit, do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, në përputhje me situacionet gjatë fazës ndërtimore, të cilat do të ndahen në raportin, 70% nga Bashkia Kavajë dhe 30% nga Federata Shqiptare e Futbollit.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota	<u>23</u>
Vota Pro	<u>23</u>
Vota Kunder	<u>-</u>
Vota Abstenim	<u>-</u>
Zbardhur me datë	<u>27/03/2025</u>

KRYETAR
RUDIN HYLYIU

